

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve H. dhe S. M. qe te dy nga fsh. N. KK Drenas, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë ne bashkëkryerje nga neni 253 par.1pika1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Publike në Gjakovë, PP.nr.317/12 të datës 18.06.2012, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **04.04.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj dhe të akuzuarve , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **H. M.**, nga fsh. N. K. Drenas, ku edhe tani banon, data e lindjes..., i biri i M. dhe i nënës H. i gjinisë G., ka te kryer shkollën e mesëm, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 3 fëmijëve, me nr. tel..., ID....,

I akuzuari **S. Ç.**, nga fsh. N. K Drenas, ku edhe tani banon, data e lindjes..., i biri i M. dhe i nënës H. e gjinisë G., ka te kryer shkollën e mesëm, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 4 fëmijëve, me nr. tel..., ID....,

J a n ë f a j t o r:

Sepse:

- Në mes te datës 12.03.2012, në kohë të pacaktuar, me qëllim qe vetit ti sjellin përfitim pasuror te kundërligjshëm, duke përvetësuar sendin e huaj te luajtshëm, pasi me pare janë marr vesh mes veti dhe i kanë ndarë rolet te përgatitur me veturën e tyre "F. U.", ne bashkëveprim pasi kanë ardhur ne fsh. M. K Gjakovë, ne seperacionin e firmës "P." prone e te dëmtuarit H. P., fillimisht kanë shkuar te seperacioni me ç'rast i akuzuari M. R. ka hipur ne trafo me mjetet e përshtatshme, paiser dhe çelës, ka çmontuar shrafat duke ra telat për toke ,ndërsa te tjerët ne pritje për vjedhje , kurse i akuzuari S. M. me veturë ka pritur tek restoranti "L." ne rrugën fsh. R. duke bere observimin dhe me këtë rast te njëjtit kanë vjedhur : 1 trafo elektrike 630W ne vlere 650 €, 2 bateri akumulator ne vlere 200 €,1 brus dhe burmashinë ne vlere prej 400€, 4 kablllo elektrike ne vlere prej 130€,6 siguresa elektrike ne vlere prej 120€, dhe 2 orëmatës elektrik ne vlere prej 2000 €, dhe pastaj kanë ikur ne drejtim te paditur duke shkaktuar me këtë rast dëme te dëmtuarit ne vlere prej 9330€.

-me çka kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë ne bashkëkryerje nga neni 253 par.1pika 1lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 3,34,41,42,43,64, 66 neni 253 par.1-1-23 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP të akuzuarve iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **H. M.**, dënim me burgim me kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit, në afatin prej **2(dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Të akuzuarit **S. M.**, dënim me burgim me kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit, në afatin prej **2(dy) vite** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari **H. P.** , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **20,00.-€**,secili **veç e veç**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzën PP.nr.593/12 të 02.10. 2012, ndaj të akuzuarve **P. A.**, **M. R.** qe te dy nga fsh.F. **KK Drenas**, dhe **H. e S. M.** nga fsh. **N. KK Drenas**, për shkak të veprës penale vjedhje e rende në bashkëkryerje nga 253/1.1-23 te **KPK-së** .

Gjykata konstaton se me Aktvendimin P.nr. 485/12 te dt. 27.01.2017, është bere veçimi i procedurës penale për te akuzuarit **H.** dhe **S. M.** sipas propozimit te prokurorit dhe pajtimit te akuzuarve **P. A.** dhe **M. R.**, me qene se te njëjtit kanë qene te pakapshëm për organet e ndjekjes dhe lënda ka marr numër te ri P.nr. 84/17.

Të akuzuarit, janë njoftuar nga nga st. policor ne Drenas, me dt. 29.03.2017 se nga ana e **GJTH** ne Gjakovë me dt. 26.02.2015, është lëshuar urdhëresë për shpalljen e letër rreshtimit për te akuzuarit, me qene se të njëjtit kane qene i pakapshëm për organet e shtetit ku sipas njoftimit nga st. policor ne Drenas, jemi njoftuar se personat e kërkuar nuk gjenden ne shtëpi dhe nuk kanë dijeni për vendodhjen, e këtë informate e kanë marr nga familjaret e tyre .

Me dt.04.04.2017, në lokalet e Gjykatës janë paraqitur të akuzuarit **H.** dhe **S.**, dhe të njëjtën ditë të njëjtit janë proceduar nga ana e gjykatës dhe gjykata ka tërhequr urdhëresën për shpalljen e letërrreshtimit, komfor nenit 537 te **KPPRK-ës**.

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë të datës 04.04.2017, përfaqësuesi i **PTH-së** në Gjakovë, Prokurori **Ismet Tofaj**, lexon aktakuzën PP.nr. 317/12 të dt.18.06.2012, me ç ‘rast prokurori bene leximin dhe deklaroi se mbetet pranë aktakuzës sa i përket të akuzuarve **H.** dhe **S. M.**, mirëpo pas shikimit te certifikatës sikur kurorëzimit te lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne G. me nr. ref. ..., i dt...., beje përmirësimin sa i përket te dhënave personale për te dy te akuzuarit ashtu qe ne vend te emirit te babait te akuzuarve **B.** duhet te

jete M. M. dhe mbiemri i vajzërisë për nënën ne vend te mbiemrit M. duhet te jete G., dhe i propozoi gjykatës që pas administrimit te provave te akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit si dhe ti obligoj ne pagesën e shpenzimeve procedurale. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit e qe u be i lirshëm e vullnetshëm duke i kuptuar pasojat u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lendes ka edhe prova tjera bindëse se kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, andaj gjykatës i propozoi që të njëjtit të shpallen fajtor, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I akuzuari P. A., gjatë shqyrtimit gjyqësorë me dt. 04.04.2017, lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet, duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, kam krijuar familje dhe jam atë i 3 fëmijëve, kërkoje falje nga i dëmtuari për demin e shkaktuar dhe te njëjtit ia kemi kompensuar demin siç ka deklaruar edhe vet i dëmtuari gjate shqyrtimi gjyqësor dt. 05.12.2014 ,andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese se pranimi i fajësisë, kohen e kryerjes se veprës penale, kompensimin e demit dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsëritet ndonjë veprë e njëjtë, të më shqiptoi një dënim më të butë.

I akuzuari S. M., gjatë shqyrtimit gjyqësorë me dt. 27.01.2017, lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet, duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, meqenëse kam krijuar familje, jam baba i 4 fëmijëve, gjithashtu i kemi bere kompensimin e demit te dëmtuarit siç ka deklaruar gjate shqyrtimit gjyqësor me dt. 05.12.2014, andaj i propozoi gjykatës që merr parash rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, të më shqiptoi një dënim më të butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që iu vihet në barrë dhe janë bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 64 dhe 66 të KPK-së , të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti përpos qe ka konstatuar se te akuzuarit kanë kryer veprën penale te vjedhjes se rende ne bashkëkryerje nga neni 253/1 pika 1.1 lidhur me nenin 23 te KPK-ës, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarit, pendimin e tyre te shprehur ne gjykatë, sjelljen e mire te akuzuarve gjate shqyrtimit gjyqësor, gjendjen e varfër ekonomike, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit për demin e shkaktuar, deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demin me qenë se i është bërë kompensimi i demit, premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsërisin vepra te njëjta penale, e te cilat rrethana ndikuan qe gjykata duke marr parasysh edhe mënyrën e kryerjes se kësaj vepre penale ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit bazuar ne nenin 66 te KPK-ës dhe te akuzuarve iu ka shqiptuar dënim me ne kohëzgjatje 8(tetë) muajve ,me kusht që në afatin prej 2(dy) vite të mos kryej veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 34 te KPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450/1 dhe 2 nen par. 2.6 te KPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 84/17 më datë 04.04.2017.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate